



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Smart X Industries" Sh.P.K. të datës 13.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Smart X Industries" Sh.P.K. të datës 13.09.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Smart X Industries" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 13.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "168 Pajisje IT – Tabela Digjitale" me nr. të prokurimit 616-25-6962-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtguesit janë cituar si në vijim: "kërkojmë nga ju që të na sqaroni se a lejohen të prezantohen deklaratat tatimore vjetore edhe nga vendi i themelimit të OE dhe jo vetëm nga Administrata tatimore e Kosovës. Tek kapaciteti teknik dhe profesional është kërkuar "5. OE duhet të zotohet që do të ofrojë Trajnime sipas nevojës dhe kohës për Produktet, Rrjeta, Hourduer dhe Souftuer", ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar "5. OE duhet të sjell një deklaratë që dëshmon se zotohet se do të trajnojë stafinë përgjegjës për shfrytëzim sipas kërkesë së AK". Formulimi i kërkesës së lartcekur është tepër i përgjithshëm dhe nuk e përcakton numrin, kohëzgjatjen dhe frekuencën e trajnimeve, gjë që krijon pasiguri të theksuar për Operatorët Ekonomikë në përllogaritjen e çmimit të ofertës. Është kërkuar: 7. OE – Duhet të ketë staf të certifikuar për Instalim, Konfigurim dhe Trajnim të Tabelave të Mençura; Dëshmia e kërkuar: 7. OE, duhet të dëshmojë me certifikatë, se ka staf të kualifikuar për, Instalim, Konfigurim, Trajnim të mësimdhënësve për TABELA të Mençura. Kërkesa e lartcekur është shumë e paqartë dhe e pa specifikuar se çka duhet të prezantojnë kompanitë ofertuese. Kjo kërkesë, në formën aktuale, është e paqartë dhe le hapësirë për interpretime të ndryshme nga Operatorët Ekonomikë. Është kërkuar: 9. OE duhet që para Ofertimit të përgatisë një planë mostër (shembull), të instalimit të rrjetave në MS Visio dhe të sjell në zyret e prokurimit. 9. Plani i shtrirjes së rrjetave (Pasive, Aktive) duhet të përgatitet në MS Visio (Mostër për një shkollë me 10 njësi mësimore) – dhe duhet të përfshihen të gjitha komponentet e cekuar në Aneksin 1. Që të prezantojë në mënyrë vizuale përgatitjen profesionale për implementim të projektit. Plani – Mostër duhet të sillët fizikisht në USB apo CD, ditën e hapjes deri ora 12 00. Kërkesa e lartcekur është e panevojshme dhe e njëjta duhet të largohet në tërësi nga dosja e tenderit".

Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësine kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se parashtguesi pretendimet i ka formuluar më tepër në aspekt të sqarimeve shtesë sesa të prezantimit të argumenteve konkrete nëse eventualisht këto kërkesa të DT sipas bindjes së parashtguesit nuk janë në përputhje me LPP. Mirëpo lidhur me këtë aspekt duhet cekur se të gjithë OE të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit e kanë pasur mundësinë që kërkojnë sqarime shtesë brenda afatit të caktuar i cili tanimë ka skaduar dukshëm. Ndërsa sa i përket pretendimit për largimin e kërkesave 8 dhe 9, ato janë kërkesa absolutisht të domosdoshme për të konfirmuar nëse OE potencial kanë kapacitetin e nevojshëm teknik dhe profesional për të realizuar këtë projekt me sukses, në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet theksuar faktin që këto pajisje teknologjike do të përdoren në shkolla nga nxënësit dhe stafi arsimor prandaj duhet evituar të gjitha mundësitë për dështimin e projektit apo realizimin e projektit në mënyrë joprofesionale qoftë pjesërisht apo plotësisht.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.09.2025

Visar SHEHU



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.